



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 56
Prishtinë, më 05. 05. 2010, në orën 12:40
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I mbledhjes së Komisionit për Integritet Evropian

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Džezair Murati, Fatmir Rexhepi, Njomza Eminidhe Nait Hasani.

Munguan: Naser Rugova dhe Petar Miletij.

Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Nga delegacioni gjerman: Frederike Kärcher, Michael Nebelung, Eckart Blaurock, Alexander Beetz, Ute Rodarian, Ramadan Islami dhe Njomza Ilazi.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite

1. Takim me përfaqësuesen e Ministrisë Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Frederike Kärcher.
2. Shqyrtimi i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe për verifikimin e sigurisë nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.
4. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin dhe për mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.
5. Shqyrtimi i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.
6. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe për luftimin e krimit kibernetik nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryesuesja konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen.

Kryesuesja - U dëshiroi mirëseardhje dhe i njoftoi për fushëveprimtarinë e Komisionit për Integritet Evropian. Specifikë e Komisionit tonë është mbikëqyrja e përmbushjes së Planit të Veprimit për Partneritet Evropian nga Qeveria. Njoftoi se Komisioni për Integritet Evropian e ka bërë Planin e Veprimit për mbikëqyrjen. Në të janë përfshirë edhe komisionet e tjera të Kuvendit. Ne e bëjmë përafrimin e legjislacionit tonë me atë të BE-së. Lidhur me përafrimin e legjislacionit deri më tani e kemi pasur mbështetjen e ekspertëve të angazhuar nga UNDP-ja dhe nga Komisioni Evropian. Po ashtu si fushëveprimtaria jona është edhe diplomacia parlamentare.

Frederike Kärcher - përfaqësuese e Ministrisë Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim - përgjegjëse për Kosovën - Tha se Qeveria Gjermane punon me dy instrumente: instrumenti i bashkëpunimit teknik dhe konsulenca, të cilat i bën GTZ-ja dhe bashkëpunimi financiar, i cili bëhet nëpërmjet Bankës Gjermane. Jemi këtu për t'i përgatitur negociatat ndërqeveritare. Sot e kemi nënshkruar një protokoll me ministrin Shala dhe kemi pasur bisedime me ministrin Beqaj. Njoftoi se kanë ofruar ndihmë për Ministrinë e Integritetit. Për ne është shumë me rëndësi t'i përfshijmë nevojat dhe kërkesat tuaja në këtë Projekt. Edhe pse Ministria e Integritetit është e re dhe Komisioni juaj është i ri, kërkoj të di se cili është bashkëpunimi i Komisionit me këtë Ministri dhe ku mund të ndihmohet. Ju thatë se e kishit mbështetjen e ekspertëve. A mund t'ju ndihmojmë në këtë drejtim?

Michael Nebelung - drejtor i GTZ - Me ju znj. Hundozi jemi takuar edhe më herët. Takimi i sotëm është sa për t'i filluar negociatat për një proces të gjatë. Dëshirojmë t'ia pasqyrojmë zonjës Frederike punën tonë dhe tuajën. Meqë jemi këtu mund t'i shohim mundësitë e bashkëpunimit.

Kryesuesja - Falënderoj për ofertën. Ne e kemi pasur edhe një takim më të gjatë me z. Nebelung, në të cilin e kam njoftuar për punën dhe për nevojat e Komisionit. Atë që ju e paraqitët, edhe unë e përkrah - do të thotë angazhimin e një eksperti për harmonizim të legjislacionit. Pasi Komisioni ynë është i ri, kemi nevojë për shkëmbim të përvojave me parlamentet e tjera, sidomos në procesin e integritetit. Po ashtu kemi nevojë për vizita studimore, por Kuvendi i Kosovës nuk ka buxhet të ndarë për to. Dëshiroj t'i dëgjojmë edhe propozimet e kolegëve, prandaj i ftoj t'i paraqesin propozimet.

Fatmir Rexhepi – I përshëndeti përfaqësuesit. Tha se jemi të vetëdijshëm për mundësitë dhe për potencialin e madh që e ka Qeveria Gjermane për të na ndihmuar në procesin e integritetit. Meqë tema bosht është thellimi i bashkëpunimit ekonomik, kemi nevojë për një zhvillim shumë më të shpejtuar. Potenciali i ri i punës, si dhe i njerëzve, që çdo ditë po shkollohen edhe jashtë Kosovës, ka nevojë për mbështetje më të madhe. Korniza ligjore na e mundëson këtë bashkëpunim. E përmbylli diskutimin duke thënë se presim nga shteti gjerman mbështetje më të mëdha në projekte konkrete në të gjitha fushat e ekonomisë. Për ne, si Komision, qëndrojnë ato kërkesa që i paraqiti edhe kryesuesja.

Frederike Kärcher - Sa u përket hollësive të bashkëpunimit do të njoftoheni shumë shpejtë. Njoftoi se në procedurat e punës së tyre së pari bëhet evaluimi i aktorëve kryesorë, në mënyrë që të shihet se ku janë nevojat dhe cilat janë kërkesat. Në momentin kur e marrim

kërkesën nga GTZ-ja, lidhur me çështjen konkrete, i miratojmë mjetet. Këto janë procedurat e rregullta. Njoftoi se i kanë 3 milionë euro për një projekt të tillë, të cilat do të miratoheshin në fund të shtatorit gjatë negociatave, pastaj bëhet një ofertë e përgatitur së bashku me përfituesin. Implementimi i tij do të fillonte më 2011. Për ne është shumë e rëndësishme të kontribuoni edhe gjatë procesit të dialogut dhe t'i paraqitni nevojat tuaja. Nëse keni pasur mundësi bashkëpunimi me Ministrinë për Integritet Evropian, në ç'nivel ishte ky bashkëpunim?

Kryesuesja - Ministria për Integritet Evropian është e re. Kemi pasur bashkëpunim shumë të mirë me Agjencinë për Integritet Evropian dhe me zëvendëskryeministrin e caktuar për integritet evropian. Njoftoi se zëvendëskryeministri ka raportuar para Komisionit çdo tre muaj lidhur me përmbushjen e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian. Pas emërimit, ministrin e kemi ftuar të raportonte para Komisionit për Planin e punës së kësaj Ministrie dhe e kemi njoftuar për punën e Komisionit dhe për pikat e dobëta, në të cilat kemi hasur. E gjithë kjo është bërë që të përmbushen sa më të shpejtë sfidat, të cilat kanë dalë para nesh si institucione. Si pikë e parë, për të cilën kemi kërkuar angazhim më të madh nga Ministria, ka qenë ndarja e buxhetit për implementimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian. Po ashtu e kemi njoftuar ministrin për mosfunksionimin e strukturave më të larta, të cilat janë krijuar për procesin e integritetit. Kemi kërkuar nga Ministria të na raportojë me shkrim për përmbushjen e sfidave.

Frederike Kärcher - Ju falënderoj për bashkëpunimin. Ju lutem, mos ngurroni t'i drejtoheni GTZ-së, Zyrës në Kosovë, për çdo pyetje ose sugjerim që mund ta keni.

Kryesuesja - E falënderoi për bashkëpunimin dhe u shpreh se janë të hapur që bashkëpunimi me GTZ-në të vazhdojë.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe për verifikimin e sigurtë nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja – E ftoi deputetin Fatmir Rexhepi - referues i këtij Projektligji ta paraqesë Raportin për këtë Projektligj.

Fatmir Rexhepi - Ky Projektligj mund të procedohet tutje, sepse nuk i cenon parimet e *acquis communautaire*.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për klasifikimin e informatave dhe për verifikimin e sigurtë me amendamentet e Komisionit Funktional është në harmoni me *acquis communautaire*.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja, referuese e këtij Projektligji, e paraqiti Raportin për këtë Projektligj.

Kryesuesja - Ky Projektligj mund të procedohet tutje, sepse nuk i cenon parimet e *acquis communautaire*.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për Kryqin e Kuq të Kosovës me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL është në harmoni me *acquis communautaire*.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin dhe për mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja, referuese e këtij Projektligji, e paraqiti Raportin për këtë Projektligj.

Kryesuesja - Ky projektligj mund të procedohet tutje, sepse nuk i cenon parimet e *acquis communautaire*.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për përdorimin dhe për mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL është në harmoni me *acquis communautaire*.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja - E ftoi deputeten Njomza Emini - referuese e këtij Projektligji, ta paraqesë Raportin për këtë Projektligj.

Njomza Emini - Ky Projektligj mund të procedohet tutje, sepse rregullohet në nivel kombëtar, andaj nuk i cenon parimet e *acquis communautaire*.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për përcaktimin e të drejtave dhe për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL rregullohet me legjislacion kombëtar.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe për luftimin e krimit kibernetik nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja e ftoi deputeten Njomza Emini- referuese e këtij Projektligji, ta paraqesë Raportin për këtë Projektligj.

*Njomza Emini - Ky Projektligj mund të procedohet tutje, sepse rregullohet në nivel kombëtar, andaj nuk i cenon parimet e *acquis communautaire*.*

Kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për parandalimin dhe për luftimin e krimit kibernetik me amendamentet e Komisionit Funkcional rregullohet me legjislacion kombëtar.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisioneve

Kryetare e Komisionit

Zylfije Hundozi